

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

BUJQËSIA, SEKTORI QË VIJON RRITJEN E QËNDRUESHME TË EKSPORTEV

+20.6% më shumë eksporte bujqësore në vlerë

+5.1% më shumë eksporte bujqësore në sasi

gjatë Janar - Korrik 2023
krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë



Raporti i Tregtisë së Jashtme nga INSTAT tregon se bujqësia është sektori me ecurinë më të qëndrueshme të eksporteve këtë vit, duke vijuar trendin rritës edhe gjatë muajit korrik, me gati 20% më shumë eksporte bujqësore. Këto të dhëna tregojnë qartë suksesin e politikave tona për nxitjen e prodhimit vendas, rritjen e cilësisë dhe të standardeve për produktet "Made in Albania", që konkurrojnë për nga cilësia e lartë në tregjet e sofistikuara të Evropës dhe më gjérë. Falë punës së fermerëve dhe të gjithë zinxhirit prodhues janë arritur këto rezultate fantastike që e kanë kthyer Shqipërinë faktor të rëndësishëm në rajon për sa i takon eksportit të prodhimeve bujqësore.

SHQIPËRIA BËHET ANËTARE E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË VERËS DHE VRESHTARISË (OIV)



“

Me anëtarësimin OIV prodhuesit tanë do të kenë akses në njohuritë më të avancuara dhe inovacionin, për të përmirësuar teknikat e prodhimit dhe për të qenë pjesë e komunitetit botëror të verës, i cili do të ndihmojë në zgjerimin e horizonteve dhe shkëmbimin e eksperiencës sonë në verëtarë.

Pas punës së bërë me ligjin e ri për verën dhe vreshtarinë i jepim një tjetër mjet të fuqishëm sektorit të verës dhe vreshtarisë duke i dhënë vëmendjen e duhur zhvillimit të tij. Historia e prodhimit të verës në Shqipëri daton që prej antikititetit. Mikroklimat e pasura të vendit tonë krijojnë një terruar që ofron varietete lokale rrushi unike, të cilat po fitojnë popullaritet dhe janë kthyer në pikën e fortë të prodhuesve shqiptarë të verës. Mjaft kantina janë kthyer nga punishte të vogla arizanale, në prodhues të mëdhenj që tashmë janë të aftë të garantojnë cilësinë dhe sasinë, duke mbyllur ekselencën dhe pasionin në një shishe, gati për dashamirësit e verës në të gjithë botën.



TASKFORCA E AKU-SË NË TERREN PËR GARANTIMIN E SIGURISË USHQIMORE

GUSHT

**12 QARQE
1304 KONTROLLE
22 MASA ADMINISTRATIVE
295 PARALAJMËRIME**

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

ZHVILLIM I QËNDRUESHEM I BLEGTORISË: PRAKTIKAT MË TË MIRA FRANCEZE ME INVESTIME INOVATORE

Investimet novatore në instalimin e paneleve diellore apo në infrastrukturën e nevojshme për ruajtjen e qumështit u kanë ardhur në ndihmë blegtoreve të malit të Çajupit të zhvillojnë më tej blegtorianë dhe të sigurojnë më shumë të ardhura.



“ Kemi zgjedhur disa stane të tillë për tili mundësuar infrastrukturën energjitike që i mungonte duke instaluar panele fotovoltaikë, inverter si dhe infrastrukturë ruajtëse me tanker ftohës, çka i mundëson këtij stani, por dhe disa blegtoreve përreth që ta që ta grumbullojnë e ta ruajnë qumështin në tankerin ftohës, që merr energji nga panelet.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca vizitoi një stan në majën e Çajupit, në Libohovë të Gjirokastrës, ku Pëllumbi, blegtor ndër breza, që rrit dele e dhi. Ai prodhon djathë për nevojat e veta, teksha ofron edhe fjetje e ushqim në stan, për vizitorët që mrekullohen me bukuritë e Çajupit, ndërsa qumështin që mbledh nga tufa e të imtave, e shet në baxhot e Gjirokastrës. Pëllumbi krahas mbështetjes me subvencione nga qeveria, ka përfituar mbështetje dhe për disa investimeve novatore si në instalimin e paneleve diellore, apo tankun ftohës të qumështit, të cilat e kanë ndihmuar atë dhe blegtoret e zonës të zhvillojnë më tej blegtorianë dhe të sigurojnë më shumë të ardhura.

42,755 FERMERË TË FINANCUAR NGA SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES NË BUJQËSI



Vijomë mbështetjen për fermerët nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2023. Deri në fund të muajit gusht janë 42,755 fermerë të cilët kanë përfituar financimin, ndërkohë AZHBR po vijon intensivisht procesin për kryerjen e pagesave për fermerët e tjera. Në Skemën Kombëtare 2023 ofrohet mbështetje për tufën bazë të matrikulluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fermat organike, certifikimin Global Gap, fara, fidanë dhe inute të tjera, rinnovimin e infrastrukturës së anijeve të peshkimit, si edhe mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi.

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

PROJEKTU I RI 8 MILIONË EURO ME BANKËN BOTËRORE,
PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DO TË SJELLË UJË
ME PRESION NË ÇDO PARCELË



Ministrja Krifca prezantoi në një takim me fermerët e Xarrës, Vrinës dhe Mursisë planin e investimeve që nis këtë vjeshtë në bashkëpunim me Bankën Botërore, me një financim prej 8 Milionë Euro, në Konispol dhe Divjakë si fazë pilotimi, e për t'u shtrirë më tej në të gjithë Shqipërinë, duke mundësuar ndërtimin e një stacioni të ri pompimi në rezervuarin e Mursisë dhe më tej rrjetëzimin e kanaleve dytësore duke mundësuar një skemë të re ujitje në funksion të fermerëve prodhues të këtyre zonave intensive bujqësore.



Përmes këtyre investimeve do të mundësohet vadirja përmes teknologjive të reja në 2,500 hektarë sipërfaqe në fushën e Mursisë, Xarrës dhe Vrinës, ku uji do të shkojë deri në parcelat individuale me ujitje me presion në çdo rrënje ndërkohë që stacioni i pompimit do të furnizohet me energji diellore duke kursyer ndjeshëm kostot.

VIJON PUNA PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJE-KULLIMIT NË BUJQËSI



Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe të Kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë, veç masave të marra në periudhen janar-maj 2023, për vënien në gatishmëri të kanaleve kryesore ujitëse, po kryejnë monitorimin edhe gjatë javëve të fundit me temperaturat e nxehta, për të vazhduar furnizimin me ujë në kapacitete maksimale të këtyre kanaleve ujitëse, të cilat mundësojnë furnizimin për kanalet e dyta dhe të treta që mbulojnë me ujitje rreth 100 000 ha toka bujqësore. Githashtu, Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit po punojnë me intensitet për kryerjen e remonteve të 27 hidrovoreve si dhe pastrimin e kanaleve kryesore kullues, për të mundësuar një infrastrukturë të kullimit optimale para fillimit të sezonit me rreshje, duke eliminuar rrezikun e përmbytjeve të tokave bujqësore dhe sigurimin e një sezioni të mbarë prodhimi për fermerët tanë edhe gjatë muajve në vijim.

ZONAT E PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË (ZPA): RRISIM MUNDËSITË E PRODHIMIT DHE FUQIZIMIN E EKONOMISË NË ZONAT BREGDETARE

Me Vendim të Këshillit të Ministrave kemi miratuar dokumentin udhëzues të politikave për Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të akuakulturës. Kështu rrismi mundësitet e prodhimit, veçanërisht në det me kosha notues ku kapaciteti i prodhimit parashikohet të shkojë rreth 30.000 tonë ose rreth 150 milion Euro vetëm për peshqit. Me këtë shtytje të re synojmë fuqizimin e sektorit si dhe rritjen e punësimit direkt dhe indirekt në të gjithë zinxhirin e vlerës, i cili sjell ekonomi më të mirë për komunitetet e zonave bregdetare dhe më shumë mundësi për shitjen e produkteve të peshkut "Made in Albania" në tregjet e eksportit.



PESHKIMI ARTIZANAL: INVESTIME NË 7 MOLE TË REJA PËR PESHKATARËT



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Qeverinë Italiane janë duke zhvilluar projektin e ndërtimit të 7 moleve të reja të zbarkimit (landing site) përgjatë bregdetit shqiptar, me një vlerë investimi prej rreth 8.2 milionë Euro, përmes së cilët synohet formalizimi dhe menaxhimi i sektorit të peshkimit artizanal duke krijuar kushtet e duhura, rritjen e sigurisë ushqimore dhe të ardhurave për peshkatarët si dhe garantimin e shitjes së produkteve në tregje me vlerë më të lartë.

Portali i Fermerit TASHMË GJENI ÇMIMET DITORE PËR PRODUKTET E PESHKUT



Portali i Fermerit, një dritare unike në shërbim të njerëzve të bujqësisë për të rritur transparencën mes prodhuesve, grumbulluesve, tregjeve dhe shërbimeve publike në ndihmë të aktiviteteve të fermerëve, ka shtuar rubrikën e re të çmimeve ditore për produktet e peshkut, ku mund të gjeni çmimet e përditësuara çdo ditë nga të gjitha tregjet e shqipërisë.